



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë
dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i
Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of
Education, Science, Technology and
Innovation*



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

KOMISIONI I PËRBASHKËT PËR ORGANIZIMIN E KONKURSIT
PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

THIRRJE PËR APLIKIM NË KONKURSIN
PËR TEKSTIN E VETËM TË PËRBASHKËT “ABETARE”

Komisioni i përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, i ngritur në bazë të programit të përbashkët të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, shpall **thirrjen për aplikim në konkursin për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”, shoqëruar me fletoren e punës.**

1. Teksti shkollor hartohet në përputhje me:
 - a. Kornizën e përbashkët të programeve të gjuhës shqipe për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare”.
 - b. Standardet e tekstit të Abetares.

2. Ftohen të aplikojnë, në konkursin për tekstin shkollor të vetëm të përbashkët “Abetare”, subjektet juridike të llojit “shtëpi botuese” të regjistruara/licencuara dhe të njohura si të tilla përkatësisht në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në paketën e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare”, miratuar në janar 2022 nga ministri i Arsimit dhe Sportit i Republikës së Shqipërisë dhe ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i Republikës së Kosovës.
3. Subjekti aplikues paraqitet, brenda kohës së orarit zyrtar të punës, te Komisioni i përbashkët për organizimin e konkursit për tekstin e vetëm të përbashkët “Abetare” për të dorëzuar dokumentacionin ligjor dhe teknik, si dhe dorëshkrimin e tekstit, përkatësisht:
 - a. **Në datat 2-3 maj 2022, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në Prishtinë.**
 - b. **Në datat 5-6 maj 2022, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në Tiranë.**
4. Shpallja e rezultateve të konkursit dhe e fituesit bëhet në muajin **qershor 2022**.
5. Aplikimet e paplota e të pasakta, që nuk janë në përputhje me përcaktimet e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare”, apo të kryera përtej afateve të parashikuara, do të refuzohen.
6. Për shkarkimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të tekstit të vetëm të përbashkët “Abetare”, [**KLKONI KËTU**](#).